

PL-BOND

Prajmer (astar) për ngjitjen e suvasë

Përshkrimi

PL-BOND është një astar për ngjitje që përbëhet nga rrëshira sintetike dhe rëra e kuarcit. Ai përdoret mbi sipërfaqe të lëmuara ose pa aftësi thithëse, në vend të shtresës së sprucos ngjitëse (me derdhje të trashë), për të rritur ngjitjen e suvasë që vjen më pas. Pas aplikimit të tij, ai krijon një sipërfaqe të ashpër që është rezistente ndaj mjedisit alkaline.

Fushat e përdorimit

PL-BOND përdoret si një astar i gatshëm për të siguruar ashpërsinë e mjaftueshme mbi sipërfaqe, kështu që ngjitja e suvasë pasuese përforcohet. Sipërfaqja që rezulton nga kjo është shumë rezistente ndaj alkalineve dhe si rezultat përbën një nënshtresë ideale për llaçin e gipsit. I përshtatshëm për përdorim në mjedise të brendshme dhe të jashtme.

Të dhënat teknike

Trajta:	në formë brumi
Ngjyra:	e kuqe e hapur
Densiteti:	1,48 kg/litër
pH:	7-9
Koha e tharjes:	1-2 orë
Shtresa pasuese pas:	4-6 orë

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtresa

Sipërfaqja që do të lyhet me astar duhet të jetë e thatë dhe krejtësisht pa pluhur, graso, papastërti etj.

2. Përdorimi

Përmbajtja e enës plastike trazohet mirë derisa të arrihet një përzierje homogjene. PL-BOND aplikohet mbi sipërfaqe me anë të furçës ose rullit, në një shtresë. Pas tharjes, vijon shtresa e llaçit.

Konsumi

300-350 g/m², në varësi të trashësisë së shtresës.

Amballazhimi

PL-BOND ofrohet në enë plastike 1 kg, 5 kg dhe 20 kg.

Magazini

Afati i ruajtjes për përdorim në enë të izoluar dhe në ambiente pa ngrica, është minimumi 24 muaj nga data e prodhimit.

Shënime

- Temperatura gjatë përdorimit duhet të jetë midis +5°C dhe +30°C.
- Nëse PL-BOND aplikohet në hapësira të jashtme, rekomandohet shtesa e çimentos në një raport prej 20% sipas peshës.

Përbërësit organikë të avullueshëm (VOC)

Sipas Direktivës 2004/42/KE (Shtojca II, tabela A), përmbajtja maksimale e lejuar e VOC-së për produktin e nënkategorisë "h", lloji WB është 30g/l (2010) për produktin e gatshëm për përdorim.

Produkti i gatshëm për përdorim PL-BOND përmban maksimumi <30 g/l VOC.

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475

www.isomat.al e-mail: info@isomat.eu